


# **M**ASKA

*Revista Elektronike  
Radio e RII në gjuhën shqipe  
Nr.3 Dhjetor i vitit 2016.*



**B**urgosja e atyre njerëzve që

pavarësisht çdo dëshire dhe buzëqeshjeje dhe pa asnjë shpresë dhe të ardhmen janë bllokuar tek zinxhiri i kultit, nuk është një çështje që mund të lihet lehtë në harresë.

Ata njerëz që përfshihen në këto kulte, përveçse humbasin karakteristikat e tyre njerëzore dhe hedhin hapa pa vetëdije, janë njerëz që përfaqësojnë ide anti-njerëzore. Kjo për arsye se ata kanë urrejtje të madhe për botën që i rrethon dhe për ta nuk bën dallim as fëmija, bashkëshortja apo prindërit e tyre. Mirëpo çështja nuk qëndron vetëm tek këta njerëz dhe gjendja e tmerrshme e tyre. Çështja qëndron tek strukturat e kultit i cili vepron i

duhet njohur dhe zbuluar identiteti, karakteristika dhe veprimtaria e kulteve dhe sidomos e kulteve terroriste. Sulmet ushtarake ndaj këtyre grupeve nuk mund të jenë efektive pa njohur saktësisht karakteristikat e kulteve që forcojnë mendimet dhe bindjet e gabuara. Në vazhdim do të njihemi me karakteristikat e kulteve dhe me strukturën e kulteve të grupeve terroriste si ISIS, Boko Haram dhe Muxhahedin-e-Khalk(MEK), kultit Xhim Xhons, Khmerët e Kuq dhe shumë kulte të tjera.

### **Përkufizimi dhe karakteristikat e kultit:**

Strukturat e kultit, kanë përkufizime të ndryshme duke u bazuar në identitetin e tyre. Për këtë arsye të nxjerrësh një përkufizim të vetëm mbi kuptimin e kultit është diçka e vështirë. Mirëpo kultit është një strukturë, e cila ka bindje të tjera dhe të devijuara. Kultit



lidhur ngushtë me terrorizmin dhe që është kthyer në një kërcënim serioz për sigurinë shoqërore në botë. Ajo çka duhet të dimë mbi lidhjen e grupeve terroriste me strukturat e kultit është se edhe pse jo çdo kult kthehet në një grup terrorist mirëpo të gjitha grupet terroriste në strukturën e tyre kanë karakteristika të ngjashme me kultin dhe këto struktura i përdorin për të thithur sa më shumë anëtarë apo për t'i inkurajuar anëtarët e tyre që të kryejnë akte terroriste. Si rezultat, për të luftuar seriozisht terrorizmin, në radhë të parë

ka proces dhe veprimtari me anë të së cilës krijohen lidhjet ku një person i mirëinformuar i detyron të tjerët që jetën e tyre ta varin tek ai. Kultet ndahen sipas disa faktorëve, që janë:

### **Roli i kryetarit.**

Kryetari është një person i zgjedhur përjetësisht i cili gjen një rol special spiritual. Ai duhet vlerësuar dhe lavdëruar vazhdimisht. Ky kryetar nuk kritikohet aspak dhe të gjithë ata që e rrethojnë u binden bindjeve dhe

mendimeve të tij. Pikërisht si Bin Ladeni i Al Kaidës dhe Masud Raxhavi i MEK, apo Al Bagdadi i ISIS dhe Xhim Xhones i kultit të krijuar prej tij në Amerikë. Kreu i kultit ndodhet mbi të gjitha të vërtetat dhe njohuritë dhe në disa raste përdoret si parametër për të matur çështjet reale nga ato joreale. Nga pikëpamja dhe ideologjia e kultit, kreu i kultit është i denjë që t'u japë përgjigje të gjitha çështjeve të ndërlukuara dhe duke u mbështetur në fuqinë e tij karizmatike mund të japë zgjidhje dhe njerëzimin t'a drejtojë tek e vërteta e menduar prej tij. Pikëpamjet dhe mendimet, apo vendimet e kryetarit, janë parametra drejtues në rrugën e së vërtetës dhe për këtë arsye kritikimi i kryetarit konsiderohet kritikim i së vërtetës. Xhim Xhones është një prej atyre kryetarëve, i cili veten e konsideronte të gjithëdijshëm dhe njohës i të gjitha çështjeve. Ai veten e konsideronte të denjë për të qenë kryetar i popullit. Si rezultat, të gjithë njerëzit duhej të ndiqnin rrugën e tij dhe çdokush që kritikonte mendimet e tij ndëshkohej nga aspekti shpirtëror dhe fizik. Disa prej ndjekësve të Xhones të cilët ishin të ndikuar nga personaliteti karizmatik i tij, kanë kryer torturat më të tmerrshme fizike dhe shpirtërore tek burrat dhe gratë që jetonin në qytetin ku vepronte Xhones. Kjo vlen edhe për kreun e grupit terrorist MEK të kryesuar nga Masud Raxhavi. Tek ky grup i vetmi që është i denjë për të dhënë mendim apo ide është vetë kryetari i madh Masud Raxhavi dhe çdokush që e kundërshton apo e kritikon atë dhe bindjet e kultit të tij, burgoset, torturohet ose vritet.

### **Struktura e pushtetit**

Struktura e pushtetit në këto kulte është piramidë totalitare me veprime autoritare dhe urdhra të njëanshme që jepen nga lartë dhe që duhen zbatuar në bazë. Në krye të piramidës qëndron kryetari, i cili ka kompetenca të pakufizuara. Në kulte njerëzit ndahen në dy grupe. Grupi i parë janë njerëzit e afërt dhe besnikë, ndërsa grupi i dytë përbëhet nga njerëzit e tjerë. Grupi i dytë që përbëhet nga njerëzit e tjerë, janë njerëz krejtësisht të huaj, të mashtruar dhe pa asnjë vlerë. Këta njerëz janë të detyruar që të respektojnë rregullat dhe

të ruajnë sekretet dhe të mos i bëjnë publike ato për të tjerët.

### **Shpëlarja e trurit**

Jetëgjatësia e një kulti varet nga niveli i shpëlarjes së trurit të secilit prej anëtarëve. Duke përdorur metodën e shpëlarjes së trurit, anëtarët marrin prirje të caktuara, bëhen radikalë, bëhen njerëz që i binden plotësisht kreut të tyre dhe kthehen në njerëz të gatshëm të bëjnë çdo gjë që ua kërkon kryetari i tyre. Padyshim se shpëlarja e trurit është elementi më i rëndësishëm për të shtuar jetëgjatësinë e kultit. Për shpëlarjen e trurit merren masa të gjera, por sipas sociologëve amerikanë, kjo metodë është e ndarë në tre faza që është shkrirja, kryerja e ndryshimeve dhe ngrirja përsëri e trurit.

- Shkrirja: Në këtë fazë të gjitha ndjenjat dhe pikëpamjet e së kaluarës të personit bëhen të paqëndrueshme duke përdorur konsultat personale, shpërblimet, ndëshkimet dhe kontaktet brenda grupit. Kjo paqëndrueshmëri krijon krizë identiteti tek njeriu. Në kohën kur personi mundohet të kujtojë të kaluarën e vet, botën, sjelljet dhe vlerat e veta, ai bombardohet me sistemin e ri dhe në fund ai arrin në rezultatin se në të kaluarën ka gabuar.

- Ngrirja: Në këtë fazë që është edhe faza e fundit, personit i jepet shpërblim sipas sjelljes së tij. Mirëpo nëse veprimet e personit nuk konfirmohen nga kryetari, ai person dëbohet nga grupi dhe nga pozita që ka fituar si dhe ndëshkohet. Me përfundimin e fazës së shpëlarjes së trurit anëtarët e grupit arrijnë bindjen se jeta e tyre përpara futjes në grup ishte e gabuar, ndërsa me futjen në grup ata kanë gjetur rrugën e drejtë që duhet ta përshkujnë. Kjo rrugë mund të përshkohet vetëm duke qenë i lidhur me kryetarin e grupit. Në këtë rrugë nuk ka rëndësi asgjë tjetër, përveçse dashurisë për kryetarin e kultit, singëritetin ndaj tij dhe bindjen ndaj urdhrave të tij.

### **Elementët e kultit:**

Ajo çka thamë më sipër, edhe pse deri diku përkufizon strukturën e kultit, mirëpo për të njohur më mirë këtë strukturë dhe pikëpamjet

e kultit, duhet të përqendrohemi në ideologjinë dhe strukturat themeluese të këtij fenomeni.

### **Elementi i kundërshtimit**

Në fillim duhet thënë se një prej elementëve primarë për shfaqjen e kultit, është ndjenja kundërshtuese ndaj grupit mëmë. Personat që kanë këtë ndjenjë, kundërshtojnë rrymat reformatore dhe lirishtetëse në grupin mëmë dhe kërkojnë të kthehen në qëllimet dhe objektivat kryesore të grupit. Për këtë arsye kultet pretendojnë se janë ndjekësit e bindjeve origjinale të grupit mëmë dhe për këtë arsye janë ndarë nga grupi. Kjo formë bindjeje që kundërshton grupin mëmë, në disa raste mund të jetë revolucion, një fe, sekt apo një fenomen social dhe në këtë mënyrë krerët e kultit zgjerojnë aktivitetet e kultit të tyre. Pikërisht ashtu si grupi Boko Haram i cili shtetin në Nigeri e cilëson të devijuar për shkak të sistemit arsimor perëndimor dhe strukturës demokratike të vendit. Ky grup pretendon për ringjalljen e islamit në Nigeri dhe se përballet me simbolet perëndimore në këtë vend dhe kërkon rikthimin e shtetit islamik. Ky grup veten e konsideron të drejtë dhe duke qenë se pretendon se qëllimet e veta janë realizimi i vullnetit të Zotit dhe i sheriatit hyjnor, grupi në fjalë lejon përdorimin e çdo akti dhune dhe vrasjeje. Kjo ide është e njëjtë edhe për grupin terrorist ISIS në Irak dhe në Siri, i cili pretendon për ringjalljen e kalifatit islam në formën fillestare, por që kundërshtohet nga shumë grupe islame. Të tillë elementë vihen re edhe në kultin fetar të Xhim Xhones në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i cili ka kundërshtuar gjendjen aktuale të kishave dhe shoqërisë amerikane.

### **Prirjet drejt një shoqërie të mbyllur**

Një prej elementëve të kulteve, është prirja drejt një shoqërie të mbyllur. Në këto kulte shoqëria ndahet nga rrethi i vet dhe mbyllet vetëm në rrethin e kryetarit të kultit. Kjo vihet re në kulte të ndryshme dhe kryetari i grupit MEK ka përdorur mekanizma të përpiktë dhe të saktë për të arritur këtë gjendje çnjerëzore. Ndër metodat e përdorura prej MEK për të

krijuar një shoqëri të mbyllur janë distancimi nga ndjenjat seksuale, sakrificat fizike dhe shpirtërore për kryetarin, divorci i detyruar, mohimi i familjes, ndarja seksuale, pohimet publike të detyruara, izolimi social dhe shpirtëror dhe krijimi i ndjenjës së frikës nga jashtë për anëtarët e kultit. Tek kulti terrorist MEK, anëtarëve të organizatës u jepet urdhri që të vendosen vetëm në vendet e ndara seksualisht, të divorcohen nga bashkëshortët dhe të ndërpresin lidhjet me miqtë dhe familjet e tyre si brenda, ashtu edhe jashtë organizatës. Dashurinë për bashkëshortin dhe familjen, ata duhet ta zëvendësojnë me dashurinë për kryetarin. Prirja për shoqëri të mbyllur vihet re qartë edhe në kultin e Xhim Xhones. Kreu i këtij kulti, në kohën kur u përball me kritika të shumta, menjëherë u dha urdhër ndjekësve dhe anëtarëve të tij që të largohen atyre vendeve ku këta anëtarë janë non-grata dhe ofendohen. Në këtë mënyrë ai me qindra anëtarë dhe ndjekës të tij, emigroi dhe krijoi qytetin Xhonestavenara. Ky qytet nuk kishte më shumë se 10 muaj që ishte krijuar. Mirëpo me futjen e këtij kulti u përhapën lajmet për vrasje, rrëmbimin e njerëzve, abuzimin e fëmijëve, torturimin e fëmijëve, ndëshkimin e vajzave, shpëlarjen e trurit, burgosjen e anëtarëve dhe torturimin e atyre njerëzve të cilët synonin të largoheshin nga qyteti. Të tilla lajme kanë tronditur shoqërinë amerikane. Mirëpo fundi i këtij kulti, ashtu si fundi i shumë kulteve të tjera, rezultoi me vetëvrasjen e 913 anëtarëve, prej të cilëve 276 ishin fëmijë.



## **Eliminimi i çdo mendimi të lirë dhe të pavarur**

Një prej elementëve krijues të kulteve është se brenda kultit anëtarëve nuk u lejohet të kenë mendim të lirë, të pavarur dhe personal. Brenda një kulturi, anëtari nuk ka informacione dhe është jashtë çdo rrjedhe tjetër dhe bllokohet në mendime të mbyllura dhe të kufizuara, të cilat janë imponuar nga kryetarët karizmatikë të kulteve. Në këto kulte çdo anëtari nuk i jepet mundësia që të mendojnë lirshëm dhe çdo anëtar është i detyruar të mendojë dhe veprojë vetëm në kuadër të mendimeve të kryetarit. Me anë të këtij elementi, anëtari i kultit kthehet në një njeri, i cili nuk bën gjë tjetër, veçse u bindet verbërisht urdhrave dhe mendimeve të kryetarit. Bindja e verbër është një prej elementëve kryesore të strukturës së kultit. Brenda kultit çdo kërkesë apo dëshirë e kryetarit është në plan të parë dhe zbatimi i tyre është prioritet i secilit anëtar. Ky faktor është i rëndësishëm për kthimin e kultit në një strukturë terroriste, ku qëllimi kryesor është zbatimi i urdhrave të kryetarit për kryerjen e akteve terroriste. Shembull i qartë është kryerja e akteve kamikaze nga ana e anëtarëve të Al Kaidës. Personat e këtij grupi pasi janë arrestuar gjatë kohës kur janë munduar të kryejnë akte kamikaze, kanë pohuar se kanë zbatuar vetëm urdhrat e eprorëve të tyre dhe nuk kanë dhënë asnjë arsye apo shpjegim mbi këtë urdhër të kryetarit për kryerjen e aktit terrorist. Gjithashtu djegia e vetes së 10 anëtarëve të grupit terrorist MEK në vendet evropiane, është bërë me urdhër të kryetarit të këtij grupi në shenjë proteste ndaj arrestimit të tij. Elementët që binden verbërisht tek sjelljet e kultit Sufie, Ismail Nezar Alamut dhe të ndjekësit të Agakhan Mahalati, si karakteristikë të tyre kanë dhurimin e floririt. Ata çdo vit duhet t'i dhurojnë kreut të tyre flori, diamante dhe gurë të çmuar, në atë masë që është pesha e kryetarit. Krerët e kulteve, vendosin kufizime të shumta ndaj lirisë së mendimit dhe anëtarët i tyre i ndalojnë që të mendojnë, pasi atë e cilësojnë kërcënimin më të madh për kultin. Për arritjen e këtij qëllimi ata bëjnë takime të shumta propagandistike duke ushtruar presione tek shoqëria, duke

imponuar punë të detyrueshme, duke i lënë njerëzit pa gjumë dhe duke i ndarë nga njëri-tjetri. Me fjalë të tjera, e drejta e lirisë së mendimit, anëtarëve u hiqet duke i izoluar ata nga shoqëria jashtë, duke i mbajtur të mbyllur, duke u hequr atyre prirjet për të menduar mbi botën jashtë dhe duke i injektuar idenë se ky anëtar në shoqërinë jashtë është i huaj dhe i vetëm.

## **Analizë përmbledhëse mbi çështjet dhe fenomenet**

Një tjetër element përkufizues i kultit është pushteti analitik i cili të gjitha çështjet dhe fenomenet e njerëzve i ndan në dy grupe të mirë dhe të këqij, dashakeq dhe dashamirë, engjëj dhe përbindësh. Pra me fjalë të tjera anëtari është i mirë deri në atë kohë kur ai ndjek urdhrat dhe rrugën e liderët dhe hedh hapa në një drejtim të caktuar, mirëpo menjëherë në kohën kur ai fillon të mendojë i pavarur dhe jashtë kuadrit të kultit, ai person apo shoqëri konsideruar i keq dhe vandal. Shembull i kësaj mund të vihet re tek grupet terroriste ISIS, Al Kaida, Boko Haram, Al-Shabab dhe organizata terroriste MEK. Grupi terrorist ISIS, çdo lloj pikëpamje apo bindje tjetër si islame ashtu edhe të krishtere i ka mohuar duke i quajtur ato rrjedha që përpiqen për të devijuar apo larguar njeriun nga rruga e drejtë. Ky është një shembull i qartë i këtij kulturi i cili veten e konsideron të vetmin grup që ka të drejtën e përcaktimit të së vërtetës dhe të tjerët jo. Kjo metodë vihet re edhe në kultin terrorist MEK i cili çdo element që bëhet shkak për largimin, distancimin apo neglizhencën e anëtarit kundrejt kryetarit e ka shpallur të ndaluar.

## **Shenjtërimi dhe bindja pa mangësi**

Kultet, mendjen e konsiderojnë burimin e njohjes. Këto kulte fenomenet materiale dhe realitetet ekzistuese në rrethin përreth, mundohen t'i përputhin me sistemin dhe strukturën e vlerave të tyre. Këta kulte përdorin shenjtërimin dhe bindjet gjoja pa mangësi të tyre për të bërë seleksionimin e çështjeve të cilat janë vetëm në shërbim të stabilitetit të tyre. Imponimi i këtyre pikëpamjeve në mesin e anëtarëve të kultit, krijon një situatë ku krijohen dyshime mbi

realitetet dhe nga ana tjetër bindjet e kultit zëvendësojnë bindjet e së kaluarës të cilat kanë qenë në përputhje me realitetin. Ky zëvendësim bëhet nëpërmjet metodave si ajo e shpëlarjes së trurit. Mirëpo në disa raste si Khmerët e Kuq në Kamboxhia, për realizimin e këtij qëllimi si metodë përdorin forcën dhe dhunën. Ky grup duke i cilësuar reale, të shenjta dhe pa mangësi idetë e veta dhe me imagjinatën e krijimit të një shoqërie vëllazërore dhe të barabartë, të gjithë njerëzit i imponojnë që të pranojnë pikëpamjet e tyre dhe të përpiqen për realizimin e këtij objekti. Khmerët për të zbatuar idenë e tyre kanë boshatisur qytetet duke i detyruar njerëzit që të shkojnë nëpër fshatra me qëllim që të punojnë në bujqësi. Por duke qenë se banorët e qyteteve nuk ishin mësuar me jetën në fshat dhe me punën në bujqësi, jeta e tyre u shkurtua dhe shumë prej tyre vdiqën. Nga pikëpamja dhe ideologjia e Khmerëve, mendimi, dija dhe shkenca ishte krim. Ata qytetarë të cilët punonin në sektorin e shërbimeve, nga Khmerët quheshin “parazitë dhe shushunja të shoqërisë”. Në shoqërinë e menduar prej Khmerëve, të gjithë duhej të ishin punëtorë dhe bujq dhe të gjithë të veshin rroba njëloj dhe në ngjyrë të zezë. Të shkoje vonë në punë do të thoshte torturë dhe vdekje. Khmerët digjnin të gjitha librat. Nëse dikush njihje gjuhë të huaj vritej. Në rrugë ata kontrollonin duart e njerëzve dhe nëse ndonjëri prej tyre duart nuk i kishte si të

punëtorit, ai konsiderohej intelektual dhe vritej në anë të rrugë. Kulte si Khmerët e Kuq dhe MEK, janë të mendimit se kanë kompetenca të veçanta për të arritur të vërtetën. Për këtë ata dënonin dhe ndëshkonin çdo gjë që ishte jashtë kuadrit të kultit dhe në shoqëri nuk pranonin asnjë bindje tjetër përveç asaj të kultit të tyre. Për këtë arsye pushteti i Pol Pot, ishte një tërbim real i shekullit të 20-të, ndërsa kulti Raxhavi (MEK) një tragjedi dhe katastrofë e madhe për këtë shekull.

### **Mohimi dhe refuzimi i tjetrit**

Ideologjia e kultit, mbron çdo gjë tjetër dhe çdo mendim apo bindje tjetër që është jashtë kuadrit të kultit.

Mohimi i tjetrit në strukturën e kultit ka përdorim themelor, pasi ndikon shumë në shfaqjen dhe vazhdimin e pikëpamjeve të kultit. Në këtë mënyrë kulti mund të vazhdojë jetën e tij vetëm duke mohuar dhe refuzuar të tjerët. Mohimi dhe refuzimi i të tjerëve përdoret për të stabilizuar elementin e mëparshëm atë të shenjtërit të ideve dhe bindjeve të kultit. Si rezultat kulti e ka të nevojshëm ekzistencën e një armiku dhe pa këtë armik kulti nuk mund të bëjë gjë. Për kultin armiku nuk mund të jetë vetëm jashtë por edhe brenda tij pasi çdo anëtar që kundërshton, kritikon apo krijon dyshime mbi kultin, ai anëtar konsiderohet armik. Kjo lloj metode vihet re qartë në kultin Khmerët e

Kuq dhe në kultin terrorist MEK. Kulti terrorist MEK, çdo element i cili bëhet shkak për ndarjen dhe distancimin e anëtarëve të vet nga kulti, si p.sh. familja e anëtarëve i konsideron dhe i cilëson armiq, ndërsa lidhjet e anëtarëve të vet me këto elementë i cilëson kërcënim për kultin. Në kultin e Khmerëve të Kuq, intelektualët dhe të arsimuarit refuzoheshin dhe ata konsideroheshin njerëz të korruptuar të perëndimit. Për këtë këta intelektualë dhe të arsimuar duheshin vranë. Edhe punonjësit e pushtetit të mëparshëm konsideroheshin armiq dhe vriteshin.



## Kultologu i njohur amerikan: Muxhahedin-e-Khalk i ka të gjitha tiparet e një kulti

**O**rganizata Muxhahedin-e-Khalk

(MEK), nga aspekti strukturor, organizativ dhe politik, i ka të gjitha tiparet dhe indekset që përdoren për njohjen e sekteve dhe kulteve: Raxhavi dhe gruaja e tij kanë rolin përcaktues dhe lidhshin karizmatik me pushtet absolut.

Ata shfrytëzojnë manipulimin mendor dhe normat e imponuara me qëllim që të ndikojnë sa më shumë tek anëtarët e MEK. Raxhavi dhe gruaja e tij e shfrytëzojnë këtë ndikim absolut për të manipuluar mendimet, idetë dhe veprimet e anëtarëve dhe për t'i përdorur ata në kuadër të interesave të lidhshimit.

Rick Alan Ross, specialist kultolog, themelues dhe kryetar i Institutit të Edukimit të Kultit (Cult Education Institute) në rajonin Trenton në New Jersey. Misioni i këtij instituti është studimi dhe analizimi i sekteve dhe kulteve destruktive si dhe i lëvizjeve dhe grupeve të dyshimta dhe ofrimi i informacioneve mbi rrugët e përballjes me ato. Gjatë 3 dekadave të kaluara, Ross ka marrë pjesë në mbi 500 mbledhje e seminare ku janë trajtuar temat e kultit. Ai si kultolog i njohur ka dëshmuar nëpër gjykata në çështje të ndryshme dhe mbi këtë temë ka zbatuar projekte studimore në shumë vende të botës.

Duke marrë ndihmë nga anëtarët dhe ish anëtarët e kulteve, ai ka mundur të identifikojë suhmë nga taktikat e përdorura nga këto grupe për të kontrolluar anëtarët e tyre dhe për të manipuluar opinionet e tyre dhe ç'është më e rëndësishmja, i ka përmbledhur në librat e tij metodat efikase për të neutralizuar këto taktika. Duke lexuar librat e Ross, njerëzit kuptojnë më thellësisht tiparet dhe karakterin e grupeve të kultit dhe mund të marrin vendime të drejta në rast se ata dhe personat rreth tyre rrezikohen të tërhiqen nga këto kulte. Më poshtë, keni të plotë intervistën që gazetari Boniad Habilian ka zhvilluar me Rick Alan

Ross në lidhje me ekzistencën e kultit në grupin terrorist MEK.

**Habilian:** Ndaj akuzave se është një kult, grupi i kryesuar nga Raxhavi ka reaguar duke deklaruar se si mund të jetë një kult kur kryen aktivitete politike! A mundet aktiviteti politik të jetë ndarëse mes kultit dhe jokultit?

**Ross:** Besimet e një grupi nuk kanë lidhje me qenien ose mosqenien e tij një kult. Janë veprimet, struktura dhe baza organizative që tregojnë nëse një grup është kult ose jo. Një kult mund të formohet mbi një bosht filozofik, politik, fetar, mjekësor, mbi eksperiencat e suksesshme personale, mbi pretendimin e marrëdhënieve me jashtëtokësorët, mbi çështje të ndryshme shkencore apo mbi artet marciale. Në përgjithësi, tre janë indekset kryesore që ekzistojnë për formulimin e një kulti. Këto indekse, për herë të parë janë trajtuar nga Robert Jay Lifton, psikolog dhe studiues i çështjeve të kulteve, të cilin e kam përmendur në librin me titull "Kultet, vështrim i brendshëm" në kapitullin "Përshkrimi i kulteve destruktive". Këto indekse janë:

1-Lidhshin karizmatik që përcakton dhe mbron parimet e përgjithshme dhe kuadrin ideor të grupit dhe në këtë mënyrë, gradualisht formon çështjen e adhurimit. Lideri ka pushtetin absolut dhe nuk përgjigjet para askujt për vendimet që merr.

2- Procesi i formimit ideologjik, nëpërmjet të cilit imponohen mendimet e liderit tek anëtarët e grupit ose rindërtimi mendor (shpëlarja e trurit).

3- Shfrytëzimi material dhe seksual si dhe të gjitha format e tjera të skllavërisë së anëtarëve të grupit nga lidhshin. Organizata Muxhahedin-e-Khalk (MEK), nga aspekti strukturor, organizativ dhe politik, i ka të gjitha tiparet dhe indekset që përdoren për njohjen e sekteve dhe kulteve: Raxhavi dhe gruaja e tij kanë rolin përcaktues dhe lidhshin karizmatik me

pushtet absolut. Ata shfrytëzojnë manipulimin mendor dhe normat e imponuara me qëllim që të ndikojnë sa më shumë tek anëtarët e MEK. Raxhavi dhe gruaja e tij e shfrytëzojnë këtë ndikim absolut për të manipuluar mendimet, idetë dhe veprimet e anëtarëve dhe për t'i përdorur ata në kuadër të interesave të lidershipit.

**Habilian:** Përvec tre indekseve kryesore që përmendët, a ekzistojnë standarde të tjera për njohjen e kulteve? A ekzistojnë këto standarde edhe në organizatën Muxhahedin-e-Khalk?

**Ross:** Lifton përmend 8 tipare të përgjithshme të kulteve.

1-Kontrolli i ambientit

2-Bindjet spirituale

3-Kërkesa për pastërti

4- Rrëfimet (konfesionet)

5-Ditura absolute e lidershipit

6-Gjuha ideologjike

7-Manipulimi mendor

8- Vetëmohimi dhe gjykimi negativ ndaj të tjerëve

Për mendimin tim, metodat e përdorura nga Muxhahedin-e-Khalk i ka të gjitha këto tipare të përmendura nga Lifton.

**Habilian:** Anëtarët e grupit Muxhahedin-e-Khalk detyrohen që çdo ditë apo çdo javë të marrin pjesë në mbledhje ku flasin për botën e tyre të brendshme dhe ku kërkojnë falje për devijimet mendore. A është kjo një metodë e përbashkët e kulteve? Ky fenomen që i ngjan rrëfimit, është një mjet apo teknikë për kontrollin e mendjes?

**Ross:** Këtë fenomen që përmendët ju, Lifton e ka trajtuar dhe analizuar shumë qartë në kapitullin 22 të librit të tij "Manipulimi mendor dhe psikologjik i totalitarizmit. Edhe unë në librin "Kultet, vështrim i brendshëm" e kam sqaruar këtë çështje në kapitullin "Shpëlarja e trurit në kulte". E kam thënë se kjo është një metodë që përdoret për kontrollin dhe manipulimin mendor të anëtarëve të kultit. Informatat sekrete që merren në këtë mënyrë, më vonë mund të

përdoren si mjet për shkatërrimin e personalitetit dhe për kontrollimin e plotë të anëtarëve.

**Habilian:** Ekzistojnë raporte të shumta si deklaratat e znj. Soltani që ka qenë anëtare drejtuese e Muxhahedin-e-Khalk dhe shumë e afër me Masud Raxhavi, se Raxhavi ka skenarë të shumtë për lidhje seksuale me femrat e këtij grupi. Si mund t'a analizoni këtë sjellje?

**Ross:** Krerët e grupeve autoritare si Muxhahedin-e-Khalk dhe ISIS, abuzojnë seksualisht me anëtarët dhe ndjekësit e tyre. Liderët nuk përgjigjen para askujt për veprimet e tyre. Askush nuk mundet të kërkojë llogari nga ata.

**Habilian:** Ideologët e grupit Muxhahedin-e-Khalk dhe në veçanti Masud Raxhavi, bëjnë përpjekje të shumta që veprimet e kultit si emërimi i grave në poste të larta dhe përulja e burrave, të duken si veprime feministe. Psh, emërimi i Marjam Raxhavi si presidente e Iranit, e cila mund të udhëheqë Iranin. A është vërtet kështu?

**Ross:** Nuk ka rëndësi se si veprojnë krerët e Muxhahedin-e-Khalk brenda grupit, e rëndësishme është se Masud dhe Marjam Raxhavi mund të krijojnë ligje të reja, mund t'i ndryshojnë ato, pra mund të bëjnë gjithçka që dëshirojnë. Ata zakonisht i shfrytëzojnë ligjet e tyre për të manipuluar dhe abuzuar me anëtarët e grupit. Atyre u pëlqejnë gjërat që kontrollojnë dhe nuk i duan gjërat që nuk i kontrollojnë dot.

**Habilian:** Mund të flisni më shumë për Raxhavi dhe gruan e tij?


**Ross:** Ata të dy janë zemra e kultit dhe konsiderohen element qendror dhe forca lëvizëse e tij. Nuk ekziston asnjë mjet monitoriues, nëpërmjet të cilit të kufizohet pushteti i tyre. Ata nuk japin llogari para askujt për veprimet dhe vendimet e tyre dhe nuk ekziston asnjë lloj transparence mbi paratë dhe financat e grupit Muxhahedin-e-Khalk.



**N**ë muajt e parë pas fitores së

Revolucionit Islamik, organizata Moxhahedin-e Khalk e quante Imam Khomeinin me terma të tillë si “Imami luftëtar madhështor”, “udhëheqës legjendar”, “luftëtar largpamës”, etj. Por në praktikë, organizata mbajti qëndrimet të ndryshme nga qëndrimet e Imam Khomeinit. Imam Khomeini duke pasur parasysh se boshti kryesor i ushtrisë

i klerikëve dhe pozita e tij në revolucion i konsolidua, organizata me sloganin e luftës kundër reaksionit, filloi të kryejë sulme propagandistike të shqoëruara nga shpifje të ulëta kundër eksponentëve efikasë dhe me përvojë të klerikëve dhe kryesisht kundër Ajetollah dr. Behehsti, Ajetollah Khamenei, Ajetollah Rafsanxhani, etj. Rë këtu një pjesë e madhe e popullit iranian u distanca nga organizata dhe puna arriti deri atje sa, organizata zyrtarisht deklaroi se kundërshtari kryesor i saj nuk është imperializmi amerikan, por reaksionar.



përbëhej nga bijtë myslimanë të popullit dhe fakti se përveç disa komandantëve, ushtria kishte qëndruar përkrah popullit, gjithmonë e përkrahte ushtrinë, por grupet majtiste hidhnin slogane për shpërbërjen e ushtrisë dhe organizata Moxhahedin-e Khalk megjithëse përipiqej të prezantohej si përkrahëse e Imamit, u bashkua me grupet majtiste dhe kërkonte shpërbërjen e ushtrisë. Megjithatë, këto qëndrime hipokrite nuk zgjatën shumë. Kur lidershipi

Taktika më e re e organizatës për të krijuar kushtet për përmbysjen e sistemit të Republikës islamike dhe për të marrë pushtetin, ishte vija e infiltrimit. Sipas z. Hashemi Rafsanxhani, anëtarët e organizatës Moxhahedin-e Khalk prej vitesh konsideroheshin si pjesë përbërëse e luftëtarëve myslimanë dhe kishin informacione shumë të sakta në lidhje me gjendjen dhe pozitën e personave si dhe mbi rrugët e infiltrimit në institucionet e

rëndësishme. Në kushte të tilla dhe në mungesë një organi të sigurisë të dalë nga gjiri i revolucionit, disa nga anëtarët e organizatës duke shfrytëzuar lidhjet e vjetra me disa funksionarë të qeverisë së përkohshme, arritën të infiltrojnë në brendësi të qendrave të ndryshme politike dhe gjyqësore, si Ministria e brendshme, kryeministria, prokuroria, gjykata revolucionare, forcat e rendit e të ushtrisë, madje edhe në brendësi të partisë Republika Islamike. Njëkohësisht, organizata filloi zgjerimin e bazës së saj dhe filloi të përpiqet për krijimin e një force paramilitare të përbërë nga përkrahësit e saj. Në ditët e para pas fitores së revolucionit, ndikimi i organizatës në gjykatat revolucionare nuk ishte shumë i dukshëm. I habitshëm ishte fakti se megjithë theksimin e vazhdueshëm të Imam Khomeinit për të mos nxituar në dënimin e të arrestuarve dhe për të amnistuar të akuzuarit, ndodhën disa ngjarje të pajustificueshme. Ali Rezvani, ish anëtar i organizatës, i cili më vonë u nda prej kësaj, në lidhje me këtë thotë: “Disa nga ekzekutimet e kryera në atë kohë

disa raste ish elementë të regjimit të Shahut janë ekzekutuar në mënyrë të fshehtë”. Ky ishte një shembull i veprimeve të dhunshme dhe hipokrite të organizatës pas fitores së revolucionit. Gradualisht, organizata duke u mbështetur tek anëtarët dhe simpatizantët e saj si dhe tek armët dhe municionet që i kishte grumbulluar në rrethana të ndryshme pas fitores së revolucionit. Filloi të shpreh në forma më të hapura dhe me pretekste të ndryshme kundërshtimin e saj ndaj sistemit të Republikës islamike dhe sidomos pas zbulimit të spiunazhit të Mohamed Reza Sa’deti, anëtar i Komitetit qendror të organizatës, i cili u arrestua duke i dhënë informacione të klasifikuara një agjenti sovjetik. Me zgjedhjen e Bani Sadr në postin e presidentit të Republikës islamike, organizata filloi të bashkëpunojë ngushtë me Bani Sadrin, për të shtuar antagonizmin brenda pushtetit dhe për të ngushtuar qëndrimet e Imam Khomeinit. Edhe Bani Sadri i cili për të eliminuar shokët e Imamit, kishte nevojë për një forcë të fuqishme të organizuar, u shpreh i gatshëm për bashkëpunim me organizatën. Nga

fitorja e revolucionit islamik e deri në organizimin e zgjedhjeve të para presidenciale, pra në më pak se një vit, u organizuan dy zgjedhje, ato parlamentare dhe për anëtarët e këshillit kushtetues. Kandidatët e



**Abolhassan Banisadr, kryeministri i parë i Iranit**

përfunduan në emër të Republikës islamike, ndërkohë që ishin anëtarët e organizatës të infiltroar nëpër gjykata, që nxitonin të kryenin ekzekutimet, madje në

organizatës, madje as kryetari i saj Masud Raxhavi, nuk arritën të fitojnë asnjë vend në këto zgjedhje. Në zgjedhjet parlamentare, kandidatët e organizatës nuk

arritën të futen në parlament, megjithëse të gjitha grupet majtiste e djathtiste nga partia “Tude”, nga “fetajanët e popullit” dhe nga “Lëvizja e lirisë” e përkrahën këtë organizatë. Kjo ishte një katastrofë për këtë organizatë që synonte marrjen e pushtetit me anët të zgjedhjeve. Por organizata e cila e kishte me nxitim marrjen e pushtetit dhe nuk mund të priste që pushtetin ta merrte me mjete demokratike dhe me votën e lirë të popullit. Organizata Moxhahedin-e Khalk për marrjen e pushtetit njihte vetëm një rrugë, atë të dhunës dhe terrorit. Si rrjedhim, pas një periudhe prej afro dy vitesh, në fillim të viti 1982, kur vendi digej nga agresioni i regjimit të Sadamit, organizata nxori në shesh armët dhe forcën e saj. Anëtarët e kësaj organizate gjatë dy viteve pas fitores së revolucionit islamik, çdo ditë dhe në çdo vend të Iranit kryenin akte të dhunshme, ndërsa nëpër gazeta dhe në botimet e tyre, hidhnin akuza, ofeza e fyerje ndaj funksionarëve dhe institucioneve të revolucionit, por funksionarët dhe populli i duronin këto veprime të ulëta, me qëllim që të evitonin konfliktin. Gjatë këtyre dy viteve organizata kishte proklamuar dhe zbatuar planin për krijimin e banesave dhe të celulave të shumta të saj. Megjithëse funksionarët ishin të informuar për programet e kësaj organizate, me qëllim ruajtjen dhe respektimin e të drejtës civile dhe ligjore të tyre, prokuroria e revolucionit në datën 9 prill 1982 publikoi një komunikatë prej dhjetë pikash, drejtuar të gjitha partive dhe grupeve,

duke kërkuar nga ato të prezantonin zyrtarisht liderët e tyre, adresat e zyrave dhe të dorëzojnë armët dhe municionet nëse i posedojnë. Organizata Moxhahedin-e Khalk nuk pranoi kërkesat e prokurori. Gazeta ‘Moxhahed’, organ i kësaj organizate, në një artikull të Masud Raxhavi, në lidhje me komunikatën e prokurorisë, shkruante: “...Armët duhet t’i ruajmë që kur të përballemi menjë luftë të brendshme, të ketë sa më pak rreziqe për revolucionarët...”. Në kohën kur Irani përballej me agresionin e gjithanshëm të regjimit të Sadamit dhe kur një pjesë e madhe e territorit të vendit ishte pushtuar, Mansur Raxhavi fliste për luftë të brendshme. Më 27 prill 1982, Imam Khomeini në bazë të qëndrimeve të tij të urta, i këshilloi grupet e armatosura si Moxhahedin-e Khalk të dorëzojnë armët dhe të rikthehen në gjirin e popullit. Në përgjigje të kësaj këshille të urtë të Imamit, organizata me pretendime e justifikime, si dhe me kërcënime, kërkoi një takim me imamin. Në përgjigje të kësaj kërkese, imami deklaroi se, nëse organizata respekton ligjet e shtetit dhe dorëzon armët, ai do të shkojë vetë në takim me liderët e saj.



**Masud Raxhavi, kreu i grupit terrorist MEK**

**N**jë prej agjencive informative në Amerikë pasi ka analizuar figurat më të afërta me grupin MEK në qeverinë e ardhshme amerikane, ka arritur në përfundimin se ky grup terrorist nuk ka asnjë vend në të ardhmen politike të Iranit.

Agjencia analitike Politico, në një artikull të saj ka analizuar personat me eksperiencë të vjetër të cilët tani janë pretenduesit kryesorë për postin e sekretarit amerikan të shtetit në qeverinë e Donald Trump. Artikulli është shkruar nga Daniel Benjamin dhe në të

për drejtimin e qendrës së inteligjencës kombëtare. Lidhja e Xhulianit dhe aktivitetet e tij ndërkombëtare, kanë tërhequr vëmendjen e medias tek ai. Xhuliani për një kohë të shkurtër dhe për të lobuar për heqjen e emrit të MEK nga lista e grupeve terroriste të Amerikës, ka marrë shumën prej 20 mijë dollarë apo edhe më shumë. Hon Bolton ish ambasador i Amerikës në OKB është një tjetër opsion i Trump për postin e sekretarit amerikan të shtetit. Ai ashtu si Xhuliani është një prej përkrahësve të MEK. Personi i tretë është Niut Kingerixh.

Ilin Cavo, ish sekretari amerikan i punës, njëkohësisht si Mic Mek Kanel lideri i shumicës në Senat, i cili kohët e fundit ka



thuhet; Në mesin e personave që pritet të prezantohen si anëtarë të kabinetit të ardhshëm të Trump, disa prej tyre kanë eksperiencën në lidhjet me grupet terroriste. Personat e propozuar nga Trump për postin e sekretarit amerikan të shtetit dhe për poste të tjera në kabinetin e tij qeveritar, kanë pasur lidhje të afërta me grupin terrorist MEK dhe kanë lobuar për këtë grup. Ky është ai grup që duart i ka lyer me gjakun e qindra amerikanëve dhe me gjakun e mijëra iranianëve në vitet 80 dhe gjatë bashkëpunimit me Sadamin në vitet 90. Një prej përkrahësve më të mëdhenj të këtij grupi është Rudi Xhuliani, ish kryebashkiaku i Nju Jorkut i cili tani ndodhet në listën e Trump për postin e sekretarit amerikan të shtetit dhe

pasur një takim jo zyrtar me Trump në fushën e tij të golfit në Nju Xhersi, gjithashtu ka lidhje financiare me grupin MEK. Mediat lidhjen e Xhulianit apo personave të tjerë si ai me grupin MEK e cilësoi një çështje kureshtare, pasi në vitin 2012 emri i këtij grupi u hoq nga lista e grupeve terroriste të Amerikës. Personat që janë mbështetës të këtij grupi, nuk i kanë kushtuar aspak rëndësi shqetësimeve mbi të kaluarën e këtij grupi dhe mbi parimet bazë politike anti-terrorizëm të Amerikës. Xhuliani në këtë aspekt është përpara personave të tjerë. Ky ish kryetar bashkie në Amerikë pretendon se është flamurtar i luftës kundër terrorizmit radikal islamik dhe lidhur me Barack Obamën ka thënë: Nuk më besohet se ai e do Amerikën.


Mirëpo nga ana tjetër vetë Xhuliani përkrah terroristët marksistë të cilët kanë vrarë amerikanët.

Anëtarët e MEK që në vigjilje kanë qenë përkrahës të dhunës. Në mesin e operacioneve të shumta terroriste që ka kryer MEK në vitet 70, mund të përmendim vendosjen e bombës dhe sulmet me armë zjarrin ndaj ushtarakëve amerikanë që në atë kohë gjendeshin në Iran. Përpjekja për të rrëmbyer ambasadorin iranian në Teheran, përpjekja për të vrarë një prej komandantëve ushtarakë amerikanë në Iran, si dhe sulmi ndaj përfaqësuesve të kompanive GMC, Shell, Pepsi, Pan American, si dhe shumë raste të tjera si këto, janë disa nga veprimet e grupit terrorist MEK. Pas fitores së revolucionit islamik, grupi MEK u kthye në një grup radikal për rrëzuar shtetin në Iran. Imam Khomeini (ra) themeluesi i Republikës Islamike të Iranit, pa pasur aspak dyshim mbi grupin MEK i preu dorën këtij grupi duke mos e lejuar të arrijë pushtetin dhe si rezultat MEK nisi sulmet me armë kundër Iranit. Përpara arratisjes së krerëve të lartë të këtij grupi në Paris në vitin 1981, në Teheran u vendosën disa bomba ku në njërin prej tyre u vranë më shumë se 70 funksionarë iranianë mes tyre Ajetollah Beheshti. Në vitin 1986 më shumë se 7 mijë anëtarë të grupit MEK, shkuan dhe u transferuan në Irak. Këta persona gjatë luftës së Irakut kundër Iranit, kanë shërbyer në interes të Sadamit. Organizata terroriste MEK, u pajis me armë nga ana e Sadamit dhe gjatë luftës ka vrarë 50 mijë ushtarë iranianë. Me përfundimin e luftës, aktet terroriste të MEK kundër Iranit nuk përfunduan por vazhduan si brenda ashtu edhe jashtë Iranit. Pas luftës së vitit 1990, grupi terrorist MEK u shfrytëzua nga Sadami për shtypjen e shiitëve dhe kurdëve. Në prill të vitit 1992, anëtarët e MEK zbatuan disa atentate dhe akte terroriste kundër ambasadave të Iranit në 13 vende të botës. Një prej këtyre atentateve ishte sulmi kundër përfaqësisë së Iranit në OKB. Ky sulm, e renditi organizatën MEK në rangun e organizatave të tjera terroriste si Al Kaida të cilët kanë kryer sulme terroriste brenda territorit amerikan. Në vitin 1997 grupi

terrorist MEK ishte në krye të listës së grupeve terroriste të Departamentit Amerikan të Shtetit. Edhe pse amerikanët nuk kishin njohuri dhe informacione mbi këtë grup, mirëpo MEK në krahasim me grupet e tjera terroriste të listës amerikane, ishte grupi që ka kryer më shumë vrasje. Në bazë të ligjeve amerikane, personat që garantonin burimet financiare për këtë grup terrorist, duhej të ndiqeshin dhe ndëshkoheshin. Vendosja e grupit terrorist MEK në listën e grupeve terroriste të Amerikës, theksonte një prej parimeve politike anti-terrorizëm të Amerikës. Ky parim është se qëllimi nuk është dhuna terroriste, por vrasja e njerëzve të pafajshëm për realizimin e qëllimeve dhe objektivave politike. Kjo politikë është ndjekur nga të gjitha qeveritë republikane dhe demokratike të Amerikës dhe qeveria e Xhorxh Bushit me sulmin kundër Irakut në vitin 2003 dhe me shkatërrimin e strehës së Sadamit për MEK, tregoi këtë angazhim në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar. Grupi gjatë agresionit amerikan kundër Irakut, i dorëzoi Amerikës të gjitha armatimet e tij dhe të gjithë personelin dhe anëtarët e vet i vendosi në kampin Ashraf, 40 km larg Bagdadit. Donald Ramsfeld ish sekretari amerikan i mbrojtjes pa dhënë asnjë shpjegim deklaroi se sipas konventës së Gjenevës, anëtarët e një organizate terroriste të huaj, janë nën mbrojtje. Me anë të këtij urdhri, mbrojtja e ushtrisë amerikane për kampin Ashraf vazhdoi deri në vitin 2009. Prej këtij viti e tutja, përgjegjësia për mbrojtjen e kampit Ashraf iu la ushtrisë amerikane. Me nisjen e agresionit amerikan kundër Irakut, grupi terrorist MEK nisi aktivitetin e tij për ta paraqitur veten si grup opozitar i Iranit dhe iu bashkua motos amerikane për ndryshimin e shtetit në Iran. Marjam Raxhavi, bashkëshortja e Masud Raxhavi kreu i grupit MEK, nga Parisi drejtonte veprimet e grupit MEK. Paraja në Uashington pastron çdo lloj gabimi. Paratë që ka dhënë grupi terrorist MEK, i ka kënaqur kundërshtarët e këtij grupi në Amerikë. Përveç Boltonit, i cili prej kohësh është një prej përkrahësve të ndryshimit të shtetit në Iran, edhe grupe republikane dhe demokratike në Amerikë, papritur u kthyen

në përkrahës të MEK. Departamenti amerikan i sigurisë së brendshme dhe ish kreu i shtabit të ushtrisë amerikane, kanë lobuar në Departamentin Amerikan të Shtetit, që ligjet të përputhen me qëllimet e grupit MEK. Mbështetësit e këtij grupit terrorist, të cilët kanë marrë shuma të mëdha parash, kanë pretenduar se këto shuma janë ndihma të popullit të thjeshtë iranian të cilët tashmë janë internuar. Mirëpo lajmet tregojnë se Sadami i ka dhënë grupit terrorist MEK shuma të mëdha parash. Përveç kësaj shumë raporte tregojnë se vendet arabe të gjirit Persik gjithashtu japin shuma të mëdha parash për Mek me qëllim që ky grup të vazhdojë armiqësinë kundër Iranit. Nga ana tjetër Kongresi në këtë çështje deri diku është lënë mënjanë. Më në fund në vitin 2012, pas lobimeve të shumta, organizata terroriste MEK u hoq nga lista e grupeve terroriste të Departamentit Amerikan të Shtetit. Po në këtë vit forcat amerikane, përgjegjësinë për kampin Ashraf ia dorëzuan ushtrisë irakiane dhe qeveria e Nuri Maleki që ishte aleate e Iranit, kërkoi mbylljen e këtij kampi. Në fillim të vitit 2009 paramilitarët shiitë dhe ushtria e Irakut, disa herë kanë sulmuar kampin Ashraf. Në një prej sulmeve të prillit të vitit 2001, 34 pjesëtarë të kampit Ashraf u

vrarë dhe shumë të tjerë u plagosën. Gjatë kohës kur në krye të Departamentit Amerikan të Shtetit ishte Hillary Clinton, në prioritet të punës së saj u vendos puna për të parandaluar vrasjen e më shumë anëtarëve të MEK. Në atë kohë asnjë vend nuk u shpreh i gatshëm për të pranuar anëtarët e një grupi terrorist. Në fund të artikullit thuhet: Lidhja e afërt me grupin MEK vazhdon të qëndrojë sekrete. Për disa të tillë si Bolton, është krejtësisht e qartë se grupe të tilla si MEK mund të luajnë rol në ndryshimin e shtetit në Iran. Këta persona kurrë nuk harrojnë shërbimet e MEK për Sadamin dhe vrasjen masive të ushtarëve iranianë. Një prej analistëve politikë i quajtur reformator i Iranit, në atë kohë ka shkruar një artikull për Financial Times dhe ka thënë; Mek nuk ka vend në të ardhmen politike të Iranit mirëpo ky grup do të kthehet në një krah të rrezikshëm në shërbim të interesave të Amerikës. Me futjen e Xhulianit apo Kingrixh në kabinetin qeveritar të Trump, prirjet në përkrahje të grupit MEK do të shtohen akoma më shumë. Sipas skandaleve të publikuara nga Nju Jork Times, Xhuliani brenda një viti, për shkak se ka marrë pjesë disa herë në takimet e MEK ka përfituar shumën 11.4 milion dollarë.



## Një vështrim mbi deklarin e fazës së sulmit politik nga ana e Marjam Raxhavi

**M**arjam Raxhavi, liderja e

organizatës terroriste Muxhahedine Khalk pas largimit të kësaj organizate nga Iraku dhe transferimit të pjesëtarëve të saj në apartamentet e Shqipërisë, këtyre ditëve po mundohet të mbushë vakumin e burrit të saj fati i të cilit nuk dihet akoma.

Ajo në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ka filluar tërheqjen nga lufta e armatosur dhe faza ushtarake dhe ka deklaruar fazën e sulmit politik dhe menjëherë pas transferimit të forcave militante të kësaj organizate në Tiranë dhe vendosjen e tyre në apartamente, me nguti ka shkuar në Shqipëri në mënyrë që duke shtuar një paragraf të ri të quajtur "Paragrafi i Shprehjes" në revolucionin e saj, të ndalojë falën në rritje e sipër të ndarjes dhe largimit të pjesëtarëve të kësaj organizate. Ajo me veprime të tilla bënë përpjekje që të indukojë për pjesëtarët e kësaj organizate terroriste që duhet harruar e kaluara dhe ta lirojnë veten vetëm duke shprehur kontradiktat politike dhe strategjike të tyre, të mjaftohen me këtë dhe për pyetjet e tyre, të mos presin përgjigjeje nga krerët e organizatës terroriste MEK. Ai gjatë kësaj kohe është munduar që me veprime të tilla të mashtrojë pjesëtarët e kësaj organizate në mënyrë që t'i mbajë ata akoma të burgosur në kampet e Tiranës dhe larg botës së jashtme. Tani për ta bërë më të qartë vendimin e Marjam Raxhavi në lidhje me deklarin e fazës së sulmit politik, ka nevojë të paraqiten disa pika të rëndësishme.

### Cikli pambarim

Masud Raxhavi pas lirimimit nga burgu i SAVAK të regjimit mbretëror Pahlavi nëpërmjet kryengritje popullore të Iranit kundër këtij regjimi, për shkak të ambicieve ekstreme që kishte për pushtet, synonte të marrë në dorë lidhshpimin e Revolucionit të popullit të Iranit dhe për këtë arsye menjëherë pas fitores së Revolucionit Islamik të Iranit në shkurt të vitit 1979, e shpalli

fazën politike dhe mendonte se së shpejti mund ta ndërrojë rrugën e Revolucionit në favor të tij dhe të arrijë në krye të pushtetit. Mirëpo me gjithë intrigat dhe komplotet e ndryshme, pas dy vite e gjysmë jo vetëm që nuk arriti qëllimet e tij, por për shkak të këtyre intrigave dhe kompleteve të tij, u bë i urreyer në masë të madhe nga ana e popullit dhe grupeve politike të Iranit. Si rezultat me zbulimin e kompleteve të dhe pasi populli iranian e refuzoi atë, Masud Raxhavi tregoi fytyrën e tij të keqe dhe të brishtë me shpalljen e fazës ushtarake në vitin 1981. Ai pas arratisjes në Francë, vazhdimisht premtonte rrëzimin e sistemit shtetëror të Republikës Islamike të Iranit dhe më vonë shkoi në Irak dhe duke i shërbyer ish-diktatorit Sadam Husejn dhe duke marrë pjesë në luftën e Irakut kundër popullit iranian, tregoi kulmin e armiqësisë së tij ndaj popullit të Iranit. Tani pas rrëzimit të Sadam Husejn dhe dëbimit poshtërues nga Irakut, bashkëshortja e tij, presidentja e rezistencës, ka shpallur fazën politike! Kjo çështje tërheq vëmendjen se raxhivistët pas gati 40 viteve kërkojnë të kthehen përsëri në shkallën e parë dhe të shpallin fazën politike. Do të thotë se ky është një cikël i pambarim nga faza politike deri në fazën ushtarake dhe pastaj përsëri në fazën politike me pakë lojë me fjalë duke ndryshuar emrin në "fazën e sulmit politik". Në këtë mënyrë ata synojnë t'i bindin forcat e tyre në Tiranë.

Zbulimi i skandaleve dhe intrigave sektariste të organizatës terroriste MEK

Në vitin 1979, organizata Muxhahedine Khalk ishte akoma e panjohur dhe populli iranian nuk kishte njohje të madhe rreth kësaj organizate dhe veprimeve të lidhshpimit të saj. Prandaj në fillim të shpalljes së fazës politike nga ana e Raxhavit, kjo organizatë shënojë një rritje të fryrë dhe fals, mirëpo nuk vonoi shumë derisa kjo organizatë hoqi maskën dhe Masud Raxhavi u kthye në fazën ushtarake duke bashkëpunuar me fuqitë e mëdha kundër popullit të Iranit. Mirëpo me gjithë ato mbështetjet financiare dhe ushtarake të Sadam Husejnit dhe të fuqive perëndimore, ai nuk arriti kurrfarë rezultati. Tani pas zbulimit të skandaleve dhe të gjitha krimeve të organizatës Muxhahedine Khalk për popullin iranian,

bashkëshortja e tij me shpalljen e fazës së sulmit politik ose më mirë të themi me tërheqjen dhe kthimin në vitin 1979, si mund të realizojë sipas saj rrëzimin e sistemit shtetëror të Republikës Islamike të Iranit?

Gjendja keqardhëse

Organizata terroriste MEK pas çarmatimit dhe largimit nga Iraku, ndodhet në një gjendje keqardhëse dhe në prag të shkatërrimit, prandaj për këtë arsye me urdhër të patronëve të saj është detyruar ta bëjë këtë tërheqje nga qëndrimet e saj të kaluara dhe po pretendon se dëshiron të largohet nga strategjia e terrorit dhe dhunës.

Ikja nga përgjigjja

Marjam Raxhavi po mundohet të ikë nga përgjigjja e shumë pyetjeve të cilat po shtrohen vazhdimisht nga pjesëtarët e organizatës MEK si ku ndodhet Masud Raxhavi? Çfarë ndodhë me rrëzimin e sistemit shtetëror të Iranit? Çfarë fati do të ketë ushtria çlirimtare pa armë dhe pa praninë e saj në Irak? Ajo në këtë mënyrë pretendon se rezistenca akoma vazhdon dhe vazhdimisht ikën nga përgjigjja e këtyre pyetjeve.

Më mbrapa nga të gjitha grupet politike

Raxhavi për shkak të së kaluarës së tij me plotë tradhti dhe gjithashtu për shkak të ambicieve të tij për pushtet absolut, ka ngjallur urrejtjen e të gjitha grupeve politike. Prandaj ajo nuk do të ketë kurrfarë rezultati edhe nëse tani me shpalljen e fazës së sulmit politik, dëshiron të hyjë në veprimtarinë politike dhe të largohet nga e kaluara e saj e zezë. Ajo më nuk mundet të jetë as edhe një alternativ siç thotë ajo vet dhe as një grup politik i njohur. Prandaj për këtë arsye dhe për shkak se nuk posedon një pozitë legjitime në mesin e opozitarëve të brendshëm dhe të jashtëm, organizata MEK radhitet në fund të të gjitha grupeve politike e cila nuk gëzon kurrfarë pozite dhe nuk tërheq vëmendjen e askujt.

Jashtë Irakut dhe pa praninë e lidërshipt

Çështje shumë e rëndësishme është kjo që në vitin 1979, organizata Muxhahedine Khalk ishte në kulmin e forcës dhe aftësisë së saj. Mirëpo Masud Raxhavi duke poseduar potencialin më të madh për zbatimin e hegjemonisë dhe për të ushtruar diktaturën mbi forcat e kësaj organizate dhe më vonë pas

formimit të ushtrisë së tij mercenare në Irak me mbështetje të Sadam Husejnit, përsëri nuk arriti të shënojë kurrfarë rezultati. Tani kjo grua e cila në mënyrë interesante u emërua në këtë pozitë nga Masud Raxhavi dhe në asnjë mënyrë nuk mund ka arritur të mbushë zbrazëtirën e tij në strukturat e organizatës, si mund ta bëjë këtë hap të madh në tërheqje jashtë Irakut dhe në botën e lirë duke u kthyer në shkallen e parë të së ashtuquajturës rezistencë dhe sipas saj, të realizojë rrëzimin e sistemit shtetëror në Iran?

Prandaj, është e qartë se mashtrimi i Marjam Raxhavi në emër të "sulmit politik", ka vetëm aspekt propagandistik dhe është paraqitur për dy qëllime kryesore.

Për shkak të konsumit të brendshëm dhe për të parandaluar pesimizmin dhe zhgënjimin e forcave të MEK pas largimit nga Iraku duke i mashtruar ato me çështje të tilla dhe për të penguar ndarjen dhe largimin e pjesëtarëve të këtij grupi terrorist.

Për shkak të konsumit të jashtëm dhe për të dërguar këtë mesazh për patronët e saj të ri, do të thotë për sheikët e Arabisë Saudite, patronët izraelit dhe të vendeve të tjera perëndimore dhe për tu paraqitur se dëshiron të largohet nga e kaluara e saj do të thotë nga lufta e armatosur dhe nga strategjia e terrorist dhe dhunës.





**P**arstoday është një sajt informativ iranian, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botë.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuenca, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, husa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili, pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programet e Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

## Parstoday.com/sq



[albanian@parstoday.com](mailto:albanian@parstoday.com)

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



[facebook.com/ParsTodayAlbanian](https://facebook.com/ParsTodayAlbanian)



[instagram.com/parstodayalbanian](https://instagram.com/parstodayalbanian)



[@ParsTodaySq](https://twitter.com/ParsTodaySq)